



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



**Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për
Buxhetin e vitit 2025**

Gusht, 2024

Hyrje

Planifikimi i buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2025, bazuar në planifikimet e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 është 12,872,214 euro. Në kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2025 janë paraparë 4,714,448 euro, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve 5,844,424 euro, mallra dhe shërbime 1,513,342 euro, subvencione dhe transfere 400,000.00 euro, si dhe shpenzime komunale 400,000.00 euro. Në kuadër të buxhetit të paraparë për vitin 2025, pjesa më e madhe e planifikimit të të hyrave janë nga Granti Qeveritar (5,185,780 euro), Granti Specifik për Arsimin (3,705,015 euro), Granti Specifik për Shëndetësinë (1,480,765 euro), si dhe të hyrat vetanake (551,054 euro).

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të 11 shtatorit 2008, si dhe Nenit 31 të UA (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Qarkoren Buxhetore 2025/01 të Ministrisë së Financave, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, në koordinim me kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, në bashkëpunim edhe me zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive komunale, Grupin Punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës, si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për Buxhetin e vitit 2025.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt të mbajtur në lokalitet).

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për Buxhetin e vitit 2025

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, me datë 10.02.2023 kryetari i Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, ka nënshkruar Vendimin për formimin e grupit punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore për projekt-buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2024. Me qëllim të zgjerimit të anëtarëve në Grupin Punues, me datë 16.06.2023 ka plotësuar Vendimin paraprak të Grupit Punues, nga tre (3) sa ishin paraparë me vendimin e parë, në nëntë (9) anëtarë: Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Lindita Kozmaqi Piraj – ZBGJ, Arben Skenderi – zyrtar financiar nga Drejtoria e Shëndetësisë, Bean Hadziasan – drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Ambientit, Nuhia Tairovci – Drejtoria për Shërbime Publike, Fari Kolloni – Zyra për Informim, Burim Aliu – Zyrtar Kryesor Financiar, Uzair Hamza – shef i Zyrës për Komunitete, si dhe Kaltrina Krasniqi – zytare për Buxhet në Drejtorinë e Arsimit. I njëjti Grup Punues ka vazhduar punën edhe në organizimin e dëgjimeve buxhetore për Buxhetin e vitit 2025.

Procesit të hartimit të Draft Buxhetit për vitin 2025 i ka paraprirë Qarkorja Buxhetore 2025/01 e Ministrisë së Financave dhe Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027. Në kuadër të dëgjimeve buxhetore të mbajtura nga data 31.07.2024 deri më datën 02.08.2024, është diskutuar dhe prezantuar Draft Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027. Për shkak të mungesës së pjesëmarrësve, dëgjimi buxhetor i planifikuar për datën 02.08.2024 nuk është mbajtur. Në këtë proces, Zyra për Informim ka qenë e angazhuar në përpilimin e procesverbaleve të cilat janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit.

Në suaza të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, ku si i tillë është përcjellë edhe me ftesat publike dhe informimi në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informatat për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës (Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/category/takimet-dhe-degjimet-publike-buxhetore/njoftimet-takimet-dhe-degjimet-publike-buxhetore/> ; Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/category/sastanaci-i-javne-budzetske-rasprave/obavestjenja/>) si dhe në mekanizma tjerë alternativë, të tilla si rrjeti social Facebook (<https://www.facebook.com/profile.php?id=100066575766996>).

Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, Komuna e Dragashit ka synuar që dokumentet e projeksioneve buxhetore të jenë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke u dhënë mundësi qytetarëve të kenë qasje në këto dokumente.

Për më tepër, Qarkorja Buxhetore 2025/01 dhe Draft KAB-i 2025-2027 janë publikuar në uebfaqen e Komuës. (Qarkorja 01: https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/05/Qarkorja-Buxhetore-2025-01_Final.pdf ; Draft KAB-i 2025-2027: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/KAB-2025-2027.docx>).

Njoftimet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë janë publikuar brenda afateve ligjore në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook. Në fund të secilit njoftim janë publikuar emailat e zyrtarëve ku qytetarët kanë pasur mundësi t'i dërgojnë kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Njoftimet janë publikuar në gjuhët zyrtare. Çdo vonesë eventuale në publikimin e njoftimeve për dëgjimet buxhetore në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit ka qenë për shkak të problemeve me funksionimin e uebfaqes.

Krahas dëgjimeve buxhetore me qytetarë të mbajtura nga ekzekutivi lokal, këtë vit për herë të parë është organizuar edhe Dëgjimi buxhetor nga Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Dragashit.

Njoftimet e publikuara në uebfaqen e Komunës:

Shqip:

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Kalendar-i-degjimeve-shqip.pdf>

2. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me Gra dhe Vajza:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Degjimi-me-Gra-Scan.pdf>

3. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorë të fshatrave të regjionit të Opojës, me OJQ, biznese, fermerë, të rinj dhe pensionistë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Degjimi-Opoje-Scan.pdf>

4. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorë të fshatrave të regjionit të Gorës, me OJQ, biznese, fermerë, të rinj dhe pensionistë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Degjimi-Gore-Scan.pdf>

Boshnjakisht:

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/07/Kalendari-i-degjimeve-boshnjakisht.pdf>

Njoftimet e publikuara në faqen zyrtare në Facebook të Komunës së Dragashit:

Shqip:

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://www.facebook.com/share/p/tXDgwzYBgvSjk63B/>

Boshnjakisht:

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://www.facebook.com/share/p/YSyDiSieUgUYH7h3/>

Grupi Punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësisë dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt-buxhetin e Komunës, kishte planifikuar shfytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen së tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, Grupi Punues përmes Zyrës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar ftesa të personalizuar për grupe të ndryshme qytetare, përfshirë: OJQ, biznese, përfaqësues të organizatave rinore etj.

Bazuar në Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues në koordinim me ekzekutivin e Komunës ka planifikuar të mbajë 3 dëgjime buxhetore, nga data 31 korrik deri më 2 gusht 2024. Dëgjimi i planifikuar për datën 2 gusht 2024 nuk është mbajtur, për shkak të mungesës së pjesëmarrësve. Në dëgjetimet buxhetore kanë marrë pjesë kryetari i Komunës, kryesuesja e Kuvendit, nënkryetari i Komunës, si dhe zyrtarja për Barazi Gjinore.

Tabela me të dhënat e përgjithshme

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, me Gra dhe Vajza	31.07.2024, 1 orë	39 pjesëmarrës	9 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, me banorë të fshatrave të regjionit të Opojës, me OJQ, biznese, fermerë, të rinj dhe pensionistë	01.08.2024, 1 orë	21 pjesëmarrës	1 pjesëmarrës ka parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Asamblesë Komunale, i organizuar nga KPF-ja	04.09.2024, 1 orë	33 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike (të drejtpërdrejta) si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa tabela e detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij Raporti.

Draft Buxheti i Komunës së Dragashit, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri në muajin shtator do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Dragashit.

Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me Gra dhe Vajza

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për KAB 2025-2027	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit te komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Ne jemi duke e parë çdo ditë që po hasim në raste të shumta dhe të llojeve të ndryshme të kancerit, te gratë. Propozoj që secila grua që është e prekur nga çfarëdo lloj i kancerit, të subvencionohet me 500 euro. Ndoshta është një shumë solide, por një përkrahje prej Kuvendit të Komunës, për me vazhdue ato tutje për trajtim.	Suada Bajrami – asambleiste e Kuvendit Komunal në Dragash	Pranohet	Kompenzimi i pagesave për gratë e prekura nga kanceri i girit në shumën prej 500 euro do të bëhet nga subvencionet e Zyrës së kryetarit të Komunës. Pagesa do të bëhet në bazë të mundësive buxhetore.
2.	1. Unë si asambleiste, pas që tani në spitalin tonë kemi gjinekologen, kam edhe një kërkesë. Kërkoj që kryetari t’ua mundësojë të gjitha grave të Komunës sonë që të bëjnë analizën e Papa Testit pa pagesë.	Anesa Mehmet – asambleiste e Kuvendit Komunal në Dragash	Pranohet	Pagesa e analizave të Papa Testit do të bëhet nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime.
3.	1. Siç e dini, ne kemi një gjinekologe në QKMF, e cila ka shumë vlerë të madhe tek ne. Si rritje të cilësisë së shërbimeve, kisha pas dëshirë që me	Ela Qafleshi – infermiere në QKMF Dragash	Pranohet	E përsëritur.

	pas mundësi për Papa Test. Edhe në qoftë se nuk ka mundësi në Komunën e Dragashit, të paktën të marrim Strisho nga Komuna jonë dhe pastaj t'i dërgojmë në Komunën e Prizrenit.			
4.	1. Propozimi im ka të bëjë me transportin publik, i sigurt dhe i përshtatshëm për gratë të cilat janë të punësuara në vendet rurale, nga qyteza e Dragashit si dhe anasjelltas, duke mundësuar tre linja, në mëngjes, drekë dhe darkë.	Adelina Dauti - infermiere në QKMF Dragash	Adresohet	Kjo kërkesë do të trajtohet me kompanitë që merren me transport dhe do të adresohet në Ministrinë përgjegjëse (Ministria për Infrastrukturë dhe Transport).
5.	1. Njëra prej kërkesave të grave është kërkesa për hapjen e çerdheve dhe kopshteve publike, ose edhe subvencionim të kujdesit privat për fëmijët. Ne si gra do të kemi më shumë mundësi për të punuar. Ne si gra, kërkojmë financim për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve, kërkojmë standarde të cilësisë, si dhe qasje për të gjithë.	Elisa Rashiti - OJQ "Avoko"	Pranohet	Çerdhja për fëmijë në qytezën e Dragashit është funksionale dhe është e kompletuar me staf, ndërsa dy qendrat e tjera më bazë në komunitet që janë hapur në fshatin Bresanë, janë në proces të transformimit në çerdhe për fëmijë.
6.	1. Si kërkesë tjetër për gratë, e kemi paraqitur si ambient mbrojtës për gratë të cilat janë të divorcuara, të cilat i nënshtrohen dhunës	Ajna Qengaj - OJQ "Avoko"	Pranohet pjesërisht	Komuna e Dragashit e përfaqësuar nga Kryetari Bexhet Xheladini, dhe znj.Dafinë Hoxha, kryesuese e ASB-së në Kosovë, nënshkruan Marrëveshjen e Mirëkuptimit për

	<p>fizike, psikologjike, për një strehim të tyre. Mendoj se krijimi i strehimoreve dhe shërbimeve mbështetëse për gratë që janë të divorcuara apo edhe të dhunuara, do t'u ndihmonte atyre shumë për krijimin e një ambienti të sigurt dhe përkrahës. Për shembull, duke iu siguruar atyre zhvillim personal, trajtim në aspektin emocional dhe psikologjik, si dhe lehtësim për rimëkëmbjen e tyre. Kështu që, mendoj se do të ishte shumë e nevojshme. Mendoj se një hapësirë e veçantë që do të zinte vend për strehimin e tyre do të ishin banesat të cilat janë pas DKRS-së, kati përdhes do të ishte një vend shumë i posaçëm.</p>			<p>implementimin e projektit "Përkrahja e integritit të grave në zonat rurale të Kosovës - Wintegra". Partner në implementimin e këtij projekti është edhe OJQ "Wenterpreneur". Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë. Projekti do të zgjasë dy vjet dhe përmes tij synohet themelimi dhe funksionalizimi i Qendrës për Angazhim të Komunitetit të grave në Komunën e Dragashit.</p>
7.	<p>1. Propozimi im, bashkë me disa anëtare që janë të pranishme këtu, është që të krijojmë një panair, nga të dyja komunitetet. Përpos veshjeve tradicionale dhe punimeve të dorës, me arrit edhe me ushqime</p>	<p>Alma Krasniqi - OJQ "Avoko"</p>	<p>Nuk pranohet</p>	<p>Komuna do të angazhohet që në të ardhmen, së bashku me organizatat e grave që merren me këtë çështje, të bëjnë organizmin e një panairi të tillë.</p>

	me e realizue, pasi që ushqimet tradicionale të trevës sonë janë shumë të njohura. Ato ushqime gjithashtu munden edhe me u ble, po edhe me u konsumue aty. Ky panair me u mbajt një herë në muaj, ku të gjitha gratë dhe vajzat munden me qenë prezente.			
8.	1. Propozimi im është që ta hapim një fabrikë për punësimin e grave, që ka qenë hapur edhe para disa viteve. Por nëse bëhet edhe hapja e çerdheve, do të bëhet edhe shumë më lehtë për gratë që me punue, sepse i kanë fëmijët më të sigurt edhe punojnë më qetë.	Anila Trupaj	Nuk pranohet	Kjo është çështje e sektorit privat. Komuna është e gatshme të ofrojë mbështetje, por nuk është përgjegjësi e saj hapja e fabrikave.
9.	1. Ne tashmë kemi gjinekologe në Komunën tonë. Kërkojmë nga kryetari i Komunës që të mundësojë sigurimin e mjeteve të nevojshme	Erona Zyberi	Pjesërisht e pranuar	Salla e lindjes në QKMF- Dragash është e kompletuar me pajisje, por mungon stafi i nevojshëm i kompletuar për kryerjen e lindjeve. Komuna do të mundohet që ta sigurojë stafin e nevojshëm.

për funksionalizimin e sallës së lindjes në QKMF të Dragashit.			
--	--	--	--

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-gra-dhe-vajza-per-buxhetin-e-vitit-2025/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/k3yk3UyegSnsDZn3/>

Boshnjakisht:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0PtRBvxR4yr8NmQ1Ke7n8GZw8ZEFWKpZXV8YZchSMY2KoQkUTwo9FjcmQQENscBeFI&id=100066575766996

Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me banorë të fshatrave të regjionit të Opojës, me OJQ, biznese, fermerë, të rinj dhe pensionistë

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për KAB 2025-2027	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Është një kërkesë që është edhe me ligj për me u zbatue, edhe në disa komuna u bo. Ekziston një nënkod buxhetor për Rini, i cili ndahet fondi i rinisë prej kulturës dhe sportit. Ky kod duhet të bëhet, fondi i Rinisë duhet me u nda prej kulturës dhe sportit, se kohëve të fundit pak rinia është duke u shkelë.	Jeton Qengaj - OJQ "Avoko"	Pjesërisht e pranuar	Komuna do të kërkojë nga Departamenti i Thesarit pranë Ministrisë për Financa, Punë dhe Transfere, nëse ekziston mundësia që të hapet një nënkod i tillë.

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-banore-te-regjionit-te-opojes-me-ojq-biznese-fermere-te-rinj-dhe-pensioniste/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/kauMVZVvcPkwemWv/>
 Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/pwCebvoyDR17Drkr/>

Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me qytetarë, i organizuar nga KPF-ja

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për KAB 2025-2027	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Unë dua ta bëj një pyetje: çfarë po bën organi mbikëqyrës? Për çka iu bëhet pagesa firmave të cilat e kanë pranuar një punë dhe nuk e kanë kryer. Këtë duhet ta kontrollojë Zyra për Ekonomi dhe Financa. Unë propozoj që të bëhet një mbledhje dhe të thirren të gjithë përfaqësuesit e fshatrave, të konsultohet në lidhje me këto dhe kësaj çështjeje t'i vihet fundi.	Dilber Halimovic – banor i fshatit Mlikë	Pranohet	Komuna do të kërkojë nga personat që janë përgjegjës në mbikëqyrjen dhe menaxhimin e projekteve, që gjatë ekzekutimit të punimeve të kërkohet cilësia më e mirë e punimeve.
2.	1. Nuk pashë askund që të ketë një rrugë për të gjithë fshatrat që të ketë një buxhet të ndarë, ku ne aludojmë sa herë që vijnë të huajt, se ne dëshirojmë të bëhemi një Komunë turistike dhe tërë Komunën e kemi të mbushur me bërlllog. Prandaj, do të kisha lut juve, meqë nuk ka kaluar ende në Kuvend, ta rishikoni një mundësi. Ka shoqata mjaft tonat, këtu të	Abaz Qengaj – banor i fshatit Pllajnik	Pranohet	Komuna do ta konsiderojë si një kërkesë të arsyeshme dhe do të organizojë pastrimin e rrugëve publike përmes aksioneve vullnetare, si dhe do krijojë një plan për eliminim e deponive ilegale.

	<p>Komunës, që mund të ndihmojnë, kemi mjaft shkolla, që një ditë mund ta shpallin ditë të pastrimit të Komunës, edhe të marrim krejt të dalim në rrugë, të heqim letra, të heqim bërllloge. Bërllloget tona, ju lutem, se kërkush nuk na i bjer nga askush.</p>			
--	--	--	--	--

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/komiteti-per-politike-dhe-financa-organizoi-sot-degjim-publik-me-qytetare-per-projekt-buxhetin-e-komunes-se-dragashit-per-vitin-2025/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/komitet-za-politiku-i-finansije-organizovao-je-danas-javnu-raspravu-sa-gradjanima-o-nacrtu-budzeta-opstine-dragas-za-2025-godinu/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/pKBMnkNFirwsfPB6/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/JRZedPtf7A3CB5e8/>

Tabela me numrin e pjesëmarrësve sipas përkatësisë gjinore dhe etnike

Nr.	Vendi i mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë			Numri i pjesëmarrësve sipas përkatësisë etnike		
		F	M	T	Shqiptar	Goran/Boshnjak	Të tjerë
1.	Dëgjimi buxhetor me Gra dhe Vajza	37	2	39	37	2/0	0
2.	Dëgjimi buxhetor me banorë të fshatrave të regjionit të Opojës, me OJQ, biznese, fermerë, të rinj dhe pensionistë	5	16	21	17	0/3	1 Amerikane
3.	Dëgjimi buxhetor i organizuar nga KPF-ja	12	21	33	27	5/1	0
	Totali:	54	39	93	81	7/4	1

Tabela me numrin e kërkesave dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit Komunal

Nr.	Vendi i mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit Komunal
1.	Dëgjimi buxhetor me Gra dhe Vajza	9	2
2.	Dëgjimi buxhetor me banorë të fshatrave të regjionit të Opojës, me OJQ, biznese, fermerë, të rinj dhe pensionistë	1	0
3.	Dëgjimi buxhetor organizuar nga KPF-ja	2	3
	Totali:	12	5

Përgatiti:
Grupi Punues